



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 5425 Prot.

Lushnje, më 29/06 /2023

RELACION

**“ PËR HAPJEN E ADRESËS DYTËSORE TË NDËRMARRJES SË PASURISË PUBLIKE DHE SHFRYTËZIMIN E KARRIERËS ME VENDNDODHJE: KODRA E PUSIT, NJËSIA ADMINISTRATIVE KARBUNARË, ZONA KADASTRALE 1181, PASURIA NR:232, BASHKIA LUSHNJE”**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

*Të nderuar zoterinj këshilltarë!*

Bashkia Lushnje e angazhuar për përmbushjen e detyrimeve ndaj banorëve të saj ka shtuar përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në territorin e saj, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Vetëm gjatë vitit 2022 nga Ndërmarrja e Paurisë Publike të Bashkisë janë shtruar mbi 8.1 km rrugë pa llogaritur këtu investimet e kryera nga fondi i Qeverisë Shqiptare. Bashkia Lushnje bazuar ne ligjin në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore neni 26 pika 1, ka zhvilluar dëgjuesën publike per marrjen e lejes Mjedisore. Bazuar në ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Synimi ynë nuk është vetëm shtrimi i rrugëve me standarte bashkëkohore por edhe realizimi i investimeve me një kosto sa më të ulët për komunitetin. Për këtë arsye institucioni ynë ka vendosur të shfrytëzojë burimet e ndodhura në territorin e tij dhe në rastin konkret shfrytëzimin e karrierës me adresë: Kodra e Pusit, Njësia Administrative Karbunarë, Zona Kadastrale 1181, Pasuria Nr:232, Bashkia Lushnje.

Shfrytëzimi i karrierës kërkon ndjekjen e procedurave ligjore për rregjistrimin e adreses dytësore. Për këtë i jemi drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës , nga e cila me anë të shkresës me Nr:7701/3 Prot, datë 12.12.2022 na lejon të kryejmë aplikimin në QKB në respekt të plotë të VKM Nr:942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”.

Aplikimi pranë administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin, në përputhje me legjislacionin e fushës të Ndërmarrjes së Pasurisë Publike edhe të adresës dytësore me vendndodhje **Kodra e Pusit, Njësia Administrative Karbunarë, Zona Kadastrale 1181, Pasuria Nr:232, Bashkia Lushnje.**

Kërkojmë mirëkuptimin tuaj për aprovimin e kësaj shtese në adresë.

***Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!***

**KRYETARI I BASHKISË**  
Eriselda Sefa



Nr	Emertimi	Gjatësia ml
	Bishqetthem	1050
	ngurrez e madhe	780
	bicakaj I ri	1100
	barbullinje	430
	karbunarë e vogel	520
	golem I vogel	1529
	hysgjokaj kurtine	560
	plug	220
	18 tetori	360
	kamcisht	1100
	lumth	250
	kolonjë	250
		8149

8.1. Km.